



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 4246 Prot.

Ballsh më, 31 . 08 .2022

**VENDIM**

Nr. 47, Datë 30/08/2022

**“PËR MIRATIMIN E AKORDIMIT TË VLERËS FINANCIARE PREJ 40.000 LEKËSH  
PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË FUNERALIT TË TË NDJERIT OLTJON  
HASANI, QYTETI BALLSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLSH, BASHKIA  
MALLAKASTËR”.**

Në zbatim të nenit 3 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 6/b, pika 2 e Ligjit 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për Miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak”, kërkesës së qytetares Barije Hasani me nr. 4023 Prot., datë 15.08.2022

**VENDOSI**

1. Miratimin e akordimit të vlerës financiare prej **40 000 (dyzetëmijë) lekësh** për mbulimin e shpenzimeve të funeralit të të ndjerit **Oltjon Hasani**, qyteti Ballsh, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, i cili ka ndërruar jetë më datë 28.07.2022, ndodhur në kushtet e nenit 6/b, pika 2 e Ligjit 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, “*Kur detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, është i pamundur, shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar*”.
2. Vlera merret përsipër nga buxheti I Bashkisë Mallakastër në artikullin 606, zëri “fond i veçantë”, planifikuar në buxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Mallakastër.



**KRYETAR**

**FITIM BARAJ**